



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Data: 19 03 2010			
Vj. Orig	Numër	Shtojca	Vlera
12	031-3579		



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas

Në vështrim të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4 paragrafi 2, nën paragrafi 4.1, nenit 8 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET kërkesa për shpronësim nr.31/10 të datës 05.03.2010 të Ipeshkvisë së Kosovës të një pjesë të ngastrës kadastrale të pronave të paluajtshme për (1)një zonë kadastrale në Llapushnik e cila evidentohet me nr.545, sipas fletës posedues nr.186, në vendin e quajtur "Gradina-Fusha", në sipërfaqe prej 02.50,00ha, e cila do të përdoret për ndërtimin e Varrezave të Komunitetit Katolik në fshatin Llapushnik, Komuna e Drenasit.
- II. Vlera e Kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse të përcaktuar me aktin nënligjor për përcaktimin e metodologjisë për llogaritjen e kompensimit për pronën e shpronësuar dhe dëmet që kanë të bëjnë me shpronësim të miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtorati për Financa dhe Buxhet dhe Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Drenasit.
- IV. Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

ORGANI SHPRONËSUSE I KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

01 Nr. _____

Drenas, më 19.03.2010

Iu dërgohet:
Të gjitha Drejtorateve
Arkivit

